

BATALIONI PARTIZAN »BAJRAM CURRI«

Në mars-prill të vitit 1943 është formua Çeta Partizane »Bajram Curri« në malësi të Gjakovës, e përbërë prej 95 luftëtarësh, nga të cilët disa shokë kanë ardhur nga Malisheva e më vonë edhe 6 shokë nga Plava.

Çeta, deri me luftimet për çlirimin e Gjakovës—më 9 shtator 1943, ka zhvilluar agjitacion e propogandë kundër okupatorit gjerman e italian në terrenin e Rekës së Kuqe, në Has, në Voksh, në Malësi të Gjakovës (Shqipëri). Ka propaganduar që sa më shumë njerëz të inkuadrohen në njësitet partizane e njëkohësisht ka formuar baza për shtrehimin e partizanëve dhe të gjithë pjesëmarrësve të Luftës Nacional-çlirimtare u ka shpjeguar qëllimet e luftës Nacionalçlirimtare, domosdoshmërinë për vëllazërim-bashkim të popujve në këtë luftë, e në anën tjetër ka demaskuar politikën mashtruese të okupatorit dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Në këtë Çetë kanë qenë të inkuadruar intelektualë, punëtorë, fshatarë të moshës mesatare dhe të rinj. Në aktivitetin e vet Çeta ka arritur rezultate të dukshme, të cilat ilustrohen edhe me faktin se okupatori italian me bashkëpunëtorët e vet u detyrua të marrë masa rigoroze kundër Çetës »Bajram Curri«.

Efektet e agjitacionit dhe të propogandës, që kanë zhvilluar partizanët e Çetës »Bajram Curri« kundër italianëve e gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, më së miri duken në muajin gusht të vitit 1943, kur, përkundër sullit të lidhur të okupatorit fashist e sherbëtorëve të tij, organizohet tubimi i hapët me fshatarët e Malësisë në Bujan dhe merret vendimi — që menjëherë të fillohet lufta e armatosur për çlirimin e Tropojës, si qendër e rrethit të Malësisë së Gjakovës, të cilën e mbante një regjiment italian. Këtij vendimi iu dha përkrahje e gjerë nga fshatarët e Malësisë dhe u bë mobilizimi i fshatarëve dhe sulmohet Tropoja menjëherë pas kapitullimit të Italisë. Pastaj, pas çlirimit të Tropojës, Shtabi i Çetës »Bajram Curri« mori vendim për ta sulmuar Gjakovën, të cilën po ashtu e mbanin forcat e armatosura të okupatorit gjermano-italian me bashkëpunëtorët e tyre. Për këtë qëllim, Çeta »Bajram Curri« së bashku me Çetën e Ramë Mujës me vullnetarët partizanë nga Malësia e Gjakovës, Hasi, e Reka e Keqe, stacionohen në Çabrat, afër Gjakovës. Këtu u bënë përgatitjet e fundit për çlirimin e Gjakovës. Komiteti i Partisë, udhëheqja e LNÇ dhe aktivistë të tjerë organizuan që njësitë guerile, skojistët e tjerë, të bashkohen në Çabrat dhe me çetën »Bajram Curri« e të tjerat ta sulmojnë dhe ta çlirojnë Gjakovën. Në atë moment udhëheqja e çetës dhe udhëheqja e Partisë morën këtë vendim:

Sulmi për çlirimin e Gjakovës të bëhet në tri drejtime. Për këtë qëllim forcat u ndanë në tri grupe.

Grupi i parë ka sulmuar në drejtim të Fabrikës së Tjegullave, rrugën kryesore Gjakovë—Pejë me detyrë që të sigurojë mbrojtjen nga gjermanët që mund të vinin nga Peja dhe të depërtojë deri në qendër të qytetit. Këtij grupi i ka prirë Zekirija Rexha etj. Ky grup i forcave partizane depërtoi deri në selinë e bashkësisë së atëhershme komunale, ku nuk gjeti asnjë prej nëpunësve të aparatit administrativ. Ky grup i forcave partizane kishte 1 mitraloz dhe armë të tjera të lehta dhe mashinka dore.

Grupi i dytë, ka sulmuar së bashku me një pjesë të çetës Partizane »Bajram Curri« dhe të çetës së Ramë Mujës dhe pjesëtarët e njësiteve guerile të qytetit, në drejtim të Tyrbes së Çabretit, rrëzë Çabretit, mëhallës Mulla Jusufit, Rrugës së Katolikëve dhe deri në qytet të kazemat. Në këtë rajon italianët dhe bashkëpunëtorët e tij kishin ngritur barikada, prandaj me këtë drejtim prej mëngjezit meri nga mesi i ditës disa herë është sulmuar ku u zhvilluan luftime të rrepta. U vranë shumë italianë dhe fashistë dhe u çarmatosën. Kur arritën te mëhalla e Mulla Jusufit përballë shtëpisë Tullumit, hasën në një grup gjermanësh dhe i gjuajtën. Ata u dorëzuan. Armatimin ua morëm partizanët vullnetarë. Një pjesë e luftëtarëve, duke i ndjekur fashistët italianë dhe bashkëpunëtorët e tyre, arrin deri te kazemat e mëdha të qytetit dhe deshën të hyjnë në to, por aty ishin vendosur gjermanët dhe tradhëtarët e vendit. Ata nuk mundën t'i marrin, kështu që mbetën këndej lumit—përroit. Në këtë luftë të Tyrbja e Çabratit, rrëzë Çabratit e Mëhalla e Mulla Jusufit dhe në Rrugë të Katolikëve janë vranë dhe plagosur mjaft partizanë. Në mes të tyre 4—5 i çuan në xhami të Mulla Jusufit dhe në xhaminë e Gërçarëve, kurse të tjerët i kanë çuar në Malësi të Gjakovës. Në këtë pjesë të frontit partizanë kishin pasur një mitraloz të rëndë italian, dy matraloza çekoslovakë dhe disa mitraloza dore dhe pushkë e bomba.

Mbas kësaj përleshje partizanët mbetën këndej përroit, kurse gjermanët, andej përroit. Kjo situatë vazhdoi disa ditë. Në shtëpinë e Xheladin Hanës dhe në shtëpinë e Avdurrahim Luzhës u çuan disa partizanë të plagosur. Shtëpitë e përmendura u përdorën si spital.

Grupi i tretë i forcave partizane të çetës »Bajram Curri«, e të tjerët, kanë pasur për detyrë mbylljen e rrugës Gjakovë—Prizren, në afërsi të lumit Lukavc dhe depërtimin në drejtim të qendrës së qytetit. Me këtë grup kanë udhëhequr Mazllum Baraku, Nexhmedin Nixha, Ibrahim Muhaxhiri e disa shokë të tjerë, ndërkaq prej armatimit më me rëndësi ka pasur mitraloza, 1 pushkamitraloz dhe një numër armësh të lehta. Grupi ka pasur detyrë kryesore, në fillim, prishjen e Urës së Lukavcit, për të penguar lëvizjen e forcave të okupatorit gjermano-italian dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Mirëpo, kjo nuk u arrit nga se grupi nuk pati në dispozicion armë të nevojshme dhe në anën tjetër ishte pengesë prezenca e kolonës italiane, e cila ishte duke u larguar nga Gjakova për në Prizren. Në një situatë të tillë, grupi partizan u detyrua të zëjë pozita përreth vijës së Mullirit të Sheh Litës, në krahun e djathtë të rrugës. Kur kolona italiane u afrua, partizanët hapën zjarr dhe italianët u përgjegjën po me zjarr dhe kështu lufta zgjati një kohë bukur të gjatë, sa më në fund kolona italiane u detyrua të shpërndahet në dy anët e rrugës kryesore.

Meqë ata kishin forca më të mëdha se grupi partizan, u detyrua të tërhiqet ngadalë nga ana e djathtë, afër qytetit, por gjithnjë duke luftuar kundër italianëve, të cilët u detyruan të drejtohen në vendin ku sot gjendet Stacioni i Duhanit. Italianët në këtë luftim patën mjaft të vranë dhe të plagosur. Një pjesë e tyre arriti të shpëtojë dhe të vazhdojë për në Prizren. Ata, në rrugë për në Prizren, i ndeshën Avdullah e Islam Morinën, duke punuar në pronën e tyre në vendin e quajtur »Nakarade« dhe që të dy i pushkatuan. Me siguri në shenjë hakmarrje për dëmet që pësuan afër Lukavcit. Pas këtij aksioni, grupi partizan u tërhoqë në drejtim të jugut të qytetit—nëpër lagjet Kusar—Gec, Taphone dhe doli te Kulla e Begut. Aty u informuan se ekziston magazina e armëve e okupatorit. Mirëpo, pas kontrollimit që bëri grupi partizan, nuk gjeti kurrfarë armësh. Grupi partizan vazhdoi rrugën për në bazën partizane në shtëpinë e Xheladin Hanës, ku ishte edhe Shtabi i Çetës partizane »Bajram Curri«. Ky grup në këtë aksion pati një të vranë nga Hasi e një të plagosur.

Popullsia e qytetit të Gjakovës, njësitet partizane i priti ngrohtë dhe si çlirimtar nga zgjedhja e okupatorit. Popullsia ndihmoi aksionin që ndërmori Çeta Partizane »Bajram Curri« së bashku me njësitet tjera partizane, njësitet guerrie e aktivistët e tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare për çlirimin e qytetit. Popullsia i ka strehuar partizanët dhe i ka siguruar ushqim dhe veshmbathjet e nevojshme.

Qyteti i Gjakovës—pjesa perëndimore e lumit Krena në anën e Çabratit—ka qenë në duart e njësiteve partizane afër 7 ditë, ndërkaq pjesa tjetër, nga ana e djathtë e lumit Krena, së bashku me kazernat qendrore, ishte në duart e forcave gjermane dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Kjo ngjarje historike bëri jehonë të madhe, jo vetëm në Gjakovë dhe rrethinë, por edhe në tërë Rrafshin e Dukagjinit, dhe bile në tërë Kosovën.

Me vendimin e Komitetit të vendit të PKJ të Gjakovës dhe të udhëheqjes së Çetës Partizane »Bajram Curri«, për arsye se ishte e pamundur të qëndrohet në Gjakovë nga se gjermanët sollën forca të mëdha ushtarake, u vendos që partizanët të tërhiqen në drejtim të fshatit Ponoshec. Në tetor të vitit 1943, kur u tërhoqën, arritën luftëtarë — partizanë të rinj — nga Gjakova e rrethina e saj, nga Peja, Prizreni, Rahoveci, Ferizaj dhe nga vendet e tjera. Kjo Çetë u rritë numërikisht. U muar vendimi që të formohet Batalioni »Bajram Curri«. Gjatë qëndrimit të Batalionit në territorin e rrethit të Gjakovës u bë agjitacion për Luftën Nacionalçlirimtare, u fol për vëllazërimin e bashkimin, për qëllimet e Luftës Nacionalçlirimtare. Në të gjitha fshatrat, ku ka vepruar ky Batalion, ka marrë masa që fshatarët mos t'ia paguajnë të »dhjetat e prodhimeve« okupatorit dhe është organizuar që në vend që të paguhen të dhjetat, sasitë e drithërave t'i shpërndahen popullsisë së varfër. Gjithashtu është penguar, sa ka qenë e mundur, çdo rekrutim i shqiptarëve nga ana e okupatorit për t'i shfrytëzuar në luftë kundër partizanëve në Mal të Zi dhe në Shqipëri. Përpos agjitacionit direkt me qytetarët nga ana e partizanëve të Batalionit »Bajram Curri«, janë shpërndarë afishet e PKJ. E tërë puna e partizanëve të Batalionit, në vendet ku ai vepronte, ishte legale dhe me popullsinë është biseduar në mënyrë të hapët për Luftën Nacionalçlirimtare, e njëherit është bërë mobilizimi i pjesëtarëve të rinj për ushtrinë Nacionalçlirimtare.

Batalioni formoi baza partizane, kurse në disa fshatra edhe këshillat nacionalçlirimtare. Pastaj, sipas urdhërit, Batalioni u nis dhe shkoi në Plavë e Guci, ku u takua me Çetën partizane të kësaj ane, të cilën e udhëhiqnin atëherë Hajro Shahmanoviçi e disa shokë të tjerë. Në këtë territor të Plavës e të Gucisë, e të fshatrave rreth këtyre, u zhvillua agjitacion e propogandë kundër okupatorit gjerman dhe shërbëtorëve të tij. U shpjeguan qëllimet e Luftës Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë e të popullit të Shqipërisë. Kur arriti Batalioni »Bajram Curri« në territorin e Plavës e të Gucisë, popullsia i bëri pritje të ngrohtë dhe kjo pati jehonë të madhe në ato vise. Me përpjekjet që bëri Batalioni »Bajram Curri«, me propogandën që zhvilloi, u arrit që një pjesë e shqiptarëve (të ashtuquajtur vullnetarët të mashtruar nga gjermanët) të kthehen në vendet e veta. Përpos këtyre, pjesëtarët e Batalionit punuan aktivisht në shpërndarjen e afisheve në Plavë e Guci. Organizuan tubime të llojllojshme me qytetarët, në të cilat është folur për bashkimin e popujve sërb, malazez, shqiptar etj. dhe që të hiqet frika se do të kthehet e vjetra. Në disa aksione ia dolën t'i çarmatosën ca xhandarë, financistë e pjesëtarë të tjerë të forcave të okupatorit. U shtua numri i partizanëve me njerëz të tjerë, nga ky territor. Me rastin e përvjetorit të Revolucionit të Tetorit në një tubim u bë fjalë për rëndësinë e tij historike. Aty u bë riorganizimi i Batalionit në çeta dhe emërimi i eporëve të Batalionit dhe të çetave. Meqë okupatori dhe shërbëtorët e tij panë efektet e arritura të partizanëve në përmasa të mëdha dhe se qytetarët u jepnin këtyre përkrahje të madhe, organizuan një sulm kundër Batalionit »Bajram Curri«. Luftimet zgjatën një ditë të tërë. Batalioni shpërtheu rrethimin, me ç'rast la të vranë Hysni Zajmin, Hajro Shahmanoviçin, Xhaferin, Ibrahim Mulla—Ulin etj.

Batalioni pas këtyre luftimeve u tërhoq në drejtim të Qeretit (Malësia e Shqipërisë), ku u takua me Batalionin »Perlat Rexhepi« të Shkodrës. Me këtë rast u formua Aradha e Përbashkët Partizane »Curri—Rexhepi«.

Batalioni Partizan »Bajram Curri«, në fillim të formimit ka pasur këto armë: dy mortaja me dy arka gjyle; një mitraloz të rëndë brenda; tre mitraloza bërnio çekosllovake; tre mitraloza italianë; armë automatike italiane dhe gjermane. Armët e tjera kanë qenë: pushkë jugosllave, italiane dhe gjermane, si dhe bomba dore të ndryshme.

Më vonë, duke u masvizuar batalioni, armatimi i tij vjen duke u shtuar gjithnjë e më tepër.

LISTA EMËRORE E ÇETES PARTIZANE »BAJRAM CURRI«
NË PRILL ËSHTË FORMUAR PREJ PJESËS TË ARADHËS
PARTIZANE »EMIN DURAKU«

1. Ramë Muja prej Malësisë
2. Mazllum Këpuska prej Gjakovës
3. Shaban Haxhija prej Malësisë
4. Mazllum Baraku prej Gjakovës
5. Metush Grezda prej Gjakovës
6. Zekerija Rexha prej Gjakovës
7. Malë Sadiku prej Malësisë
8. Hasan Haxhija prej Malësisë

9. Mehmet Dermoni prej Malësisë
10. Veli Nimoni prej Malësisë
11. Beqir Ndou prej Malësisë
12. Maxhun Nimoni prej Malësisë
13. Sahit Shasivari prej Gjakovës
14. Mehmet Bajrami prej Malësisë
15. Ali Ukshini prej Malësisë
16. Mazllum Cana prej Gjakovës
17. Sokol Nika prej Gjakovës
18. Mark Gega prej Gjakovës
19. Dërgut Vokshi prej Gjakovës
20. Emin Dauti prej Gjakovës
21. Shaban Zeneli prej Gjakovës
22. Halil Meta prej Gjakovës
23. Hysni Dobruna prej Gjakovës
24. Halil Metë Vokshi prej Gjakovës
25. Haxhi Vokshi prej Gjakovës
26. Xheladin Hana prej Gjakovës
27. Xheladin Nixha prej Gjakovës
28. Qamil Brovina prej Gjakovës
29. Ibrahim Beka prej Malësisë
30. Ahmet Sadrija prej Malësisë
31. Nezir Rexhepi prej Suharekës
32. Gani Çavdërbasha prej Prizrenit
33. Ymer Pula prej Gjakovës
34. Xhevdet Hamza prej Gjakovës
35. Sahit Zatriqi prej Pejës
36. Shaban Gutiqi prej Pejës
37. Sahit Bakalli prej Gjakovës
38. Fahri Ramadani prej Shkodrës
39. Avdyl Bekteshi prej Shkodrës
40. Ali Jaha prej Gjakovës
41. Shaban Nimani prej Malësisë
42. Ali Nimani prej Malësisë
43. Mirash Ndou prej Malësisë
44. Idriz Rexhepi prej Malësisë
45. Bajram Haxhija prej Malësisë
46. Tahir Mala prej Malësisë
47. Arshim Kokona prej Shqipërisë
48. Spiro Toska prej Shqipërisë
49. Miqo Giliq prej Pejës
50. Miqo Miqković prej Pejës
51. Branko Zhivalović prej Pejës
52. Nexhmedin Nixha prej Gjakovës
53. Xhavit Brovina prej Gjakovës
54. Ibrahim Muhaxheri prej Gjakovës
55. Hysni Lajçi prej Gjakovës
56. Hysni Zajmi prej Gjakovës
57. Jah Salih i Sali Monit prej Malësisë
58. Bije Vokshi prej Gjakovës
59. Faik Pruthi prej Gjakovës

Gjithashtu i janë bashkuar në Bjeshkët e Nemuna edhe një grup partizanësh prej Plavës dhe Gucisë, Çetës »Bajram Curri«. Këta janë:

60. Hajro Shabanoviq prej Plavës
61. Bejto Shamanoviq prej Plavës
62. Jusuf Haxhipaqiq prej Plavës
63. Alo Avdiq prej Gucisë
64. Ibrahim Mullauli prej Plavës
65. Salo Shujak prej Gucisë

Shokë të tjerë nuk na kujtohen.

SHENIMET I DHANË KETA SHOKË:

1. Mazllum Baraku
3. Xheladin Nixha
2. Metush Grezda

LISTA E BATALIONIT PARTIZAN »BAJRAM CURRI«,
I CILI ËSHTË FORMUAR MË 15 SHTATOR 1943

- | | |
|-----------------------|--|
| 1. Qamil Brovina | 32. Dena Gërkoviq |
| 2. Xhevdet Hamza | 33. Qamil Sharku |
| 3. Shaban Haxhija | 34. Pavle Marjan |
| 4. Ymer Pula | 35. Alija Abdiq |
| 5. Boshko Qaktiqi | 36. Salo Shujak |
| 7. Cane Vasiq | 37. Bejta Shumanoviq |
| 9. Hamid Thaqi | 38. Alush Gashi |
| 8. Sahit Shasivari | 39. Sherif Boshnjaku |
| 10. Zhika Stojanoviq | 40. Ramiz Kelmendi—Xhema |
| 11. Metë Gunga | 41. Nikollë Gega |
| 12. Sahit Bakalli | 42. Hivzi Gorani |
| 13. Andrija Perunqiq | 43. Sami Peja |
| 14. Gjoko Gjorgjeviq | 44. Niko Drijeviq |
| 15. Vaso Bogdanoviq | 45. Miljeta Peroviq |
| 16. Sahit Zatriqi | 46. Silija prej Prizrenit |
| 17. Stanoje Aksić | 47. Ramadan Krymadhi
prej Prizrenit |
| 18. Shaban Kajtazi | 48. Osman Perolli |
| 19. Ali Jaha | 49. Shaban Zejneli |
| 20. Esat Mekuli | 50. Xhafer Vokshi |
| 21. Nexhip Habibaj | 51. Sutki Hoxha |
| 22. Kolë Shiroka | 52. Zekerija Rexha |
| 23. Rajko Boriqiq | 53. Xheladin Hana |
| 24. Shaban Gutiq | 54. Hysni Lajçi |
| 25. Misho Miqkoviq | 55. Regjop Gashi |
| 26. Spase Mihajlovic | 56. Musa Muhaxheri |
| 27. Mehmet Mëliqi | 57. Hysen Gashi—baba |
| 28. Arif Karnabi | 58. Bekë Jusuf Qorri |
| 29. Idriz Brika | 59. Metush Grezda |
| 30. Shani Qamili | 60. Sokol Nika |
| 31. Hajredin Vullkani | |

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 61. Tafil Hoxha | 85. Gani Hoxha |
| 62. Xheladin Nixha | 86. Gani Çavdërbasha |
| 63. Halil Meta | 87. Hajro Shamanoviq |
| 64. Mazllum Baraku | 88. Hajdar Dushi |
| 65. Mazllum Cana | 89. Hysni Zajmi |
| 66. Nexhmedin Kuqi | 90. Hysni Dobruna |
| 67. Marku prej Ramoci | 91. Ibrahim Mullahuli |
| 68. Xhavit Brovina | 92. Jahë Sali Batusha |
| 69. Jusuf Zherka | 93. Mazllum Këpuska |
| 70. Fadil H. Hoxha | 94. Miqo Giliq |
| 71. Ibrahim Tërnovci | 95. Nexhmedin Nixha |
| 72. Vllau i Shaban Gutiqit | 96. Zaharija Bashanoviq |
| 73. Munir Dushi | 97. Dy vllëzër Radovanoviq |
| 74. Dragan Kovaçeviq | 98. Emin Dauti |
| 75. Pero Reshtar | 99. Halil Metë Vokshi |
| 76. Emin Tezja e Prizrenit | 100. Nez Rexhepi |
| 77. Qamil Hoxha | 101. Rasim Cokolli |
| 78. Ramo Brković | 102. Shefki Shasivari |
| 79. Tomo Tomoviq | 103. Vani Djorgjeviqi |
| 80. Branko Zhivaloviq | 104. Musa Ferizi |
| 81. Dërgut Vokshi | 105. Haxhi Imeri, Slup Voksh |
| 82. Xhafer Nikoçeviq | |
| 83. Xhafer Hysen Mitrovica | |
| 84. Xhemajl Shkociolli | |

SHOKËT TË CILËT KANË MARRË PJESË NË KËTË BATALION TË
VITIT 1943 KANË QENË PREJ GJAKOVËS — MALËSISË — SHQIPËRISË

- | | |
|------------------------|---------------------------|
| 106. Veli Nimani | 119. Idriz Rexhepi |
| 107. Maxhun Nimani | 120. Ali Ukshini |
| 108. Shaban Nimani | 121. Hasan Haxhija |
| 109. Ali Nimani | 122. Bajram Haxhija |
| 110. Malë Sadiku | 123. Enver Dajci |
| 111. Beqir Ndou | 124. Tahir Mala |
| 112. Mirash Ndou | 125. Bute Mal Sadiku |
| 113. Mehmet Dermoni | 126. Arshan Kukona |
| 114. Shpend Dega | 127. Spiro Toska |
| 115. Zoge Dega | 128. Refki Dauti |
| 116. Ibrahim Beka | 129. Shaban Kajtazi |
| 117. Ahmet Sadrija | 130. Hamit Thaçi |
| 118. Mehmet Bajraktari | 131. Beka prej Ponoshecit |

SHENIMET I DHANË KETA SHOKË:

1. Mazllum Baraku
2. Xheladin Nixha
3. Metush Grezda

SHOKËT E KOMITETIT TË PARTISË DHE KOMUNISTËT,
AKTIVISTËT E LUFTËS NACIONALÇLIRIMARE TË QYTETIT
TË GJAKOVËS SI DHE SHOKËT QË KANË QENË NË NJËSITË
GUERILE KANË MARRË PJESË AKTIVE NË LUFTË
MË 9, 10 SHTATOR NË KAPITULLIMIN E ITALISË
PËR ÇLIRIMIN E GJAKOVËS

1. Jusuf Zherka prej Gjakovës
2. Islam Spahija prej Gjakovës
3. Zenel Zherka prej Gjakovës
4. Musa Efendija prej Gjakovës
5. Mazllum Polloshka prej Gjakovës
6. Etëhem Spahija prej Gjakovës
7. Hilmi Sina prej Gjakovës
8. Qamil Zenuni prej Gjakovës
9. Hilmi Luzha prej Gjakovës
10. Avdi Bakalli prej Gjakovës
11. Esat Hoxha prej Gjakovës
12. Sani Hoxha prej Gjakovës
13. Ibrahim Haxhija prej Gjakovës
14. Xajë Gola prej Gjakovës
15. Ismet Zherka prej Gjakovës
16. Lahë Brovina prej Gjakovës
17. Mazllum Lakuci prej Gjakovës
18. Shani Olloni prej Gjakovës
19. Ali Manxhuka prej Gjakovës
20. Hysen Zherka prej Gjakovës
21. Naïm Zajmi prej Gjakovës
22. Xhevdet Pula prej Gjakovës
23. Tafil Hoxha prej Gjakovës
24. Shefqet Kerraxhija prej Gjakovës
25. Zenel Spahija prej Gjakovës
26. Ismet Bytyqi prej Gjakovës
27. Shaip Petershoni prej Gjakovës
28. Ali Çurdina prej Gjakovës
29. Çemajl Barballushi prej Gjakovës
30. Tasim Stavileci prej Gjakovës
31. Malush Stavileci prej Gjakovës
32. Surri Muhaxheri prej Gjakovës
33. Zenel Bakalli prej Gjakovës
34. Khavit Muhaxheri prej Gjakovës
35. Fehmi Hoxha prej Gjakovës
36. Qamil Nixha prej Gjakovës
37. Fadil Bakdja prej Gjakovës

38. Ramiz Abrashi prej Gjakovës
39. Nuredin Tullumi prej Gjakovës
40. Ymer Dauti prej Gjakovës
41. Xhevdet Shehu prej Gjakovës
42. Qemajl Thaqi prej Gjakovës
43. Fehrat Thaqi prej Gjakovës
44. Zeq Zeka Hoxha prej Gjakovës
45. Minir Canhasi prej Gjakovës
46. Ibrahim Mula prej Gjakovës
47. Isa Mula prej Gjakovës
48. Isa Dujaka prej Gjakovës
49. Fehrat Binishi prej Gjakovës
50. Faik Binishi prej Gjakovës
51. Asim Blyta prej Gjakovës
52. Fadil Hysen (Hoxha) prej Gjakovës
53. Sutki Hysen (Hoxha) prej Gjakovës
54. Hysen Hoxha prej Gjakovës
55. Rexhep Dobruna prej Gjakovës
56. Shani Hoxha prej Gjakovës
57. Vehap Shita prej Gjakovës
58. Shaq Zeka prej Gjakovës
59. Din Shehu prej Gjakove
60. Nazmi Xhahnemi prej Gjakovës
61. Avdullah Gllloxhani prej Gjakovës
62. Sadik Pozhegu prej Gjakovës
63. Isa Stuja prej Gjakovës
64. Metë Gunga prej Gjakovës
65. Zenel Luzha prej Gjakove
66. Izet Hadri prej Gjakovës
67. Mustafa Bakija prej Gjakovës
68. Hysni Zajmi prej Gjakovës
69. Ejup Vokshi prej Gjakovës
70. Bajram Shllaku prej Gjakovës
71. Shan Selim Hoxha prej Gjakovës
72. Reshat Hadri prej Gjakovës
73. Musa Dobruna prej Gjakovës
74. Izet Duraku prej Gjakovës
75. Tahir Spahija prej Gjakovës
76. Gani Pula prej Gjakovës
77. Malush Kupa prej Gjakovës
78. Nazmi Vula prej Gjakovës
79. Ismet Shaqiri prej Gjakovës

80. Hyani Zajmi prej Gjakovës
81. Hamdi Shehu prej Gjakovës
82. Katica Brajeviq prej Pejës
83. Smajl Dobruna prej Gjakovës
84. Tafa Ali Aga prej Gjakovës
85. Beqir Hajredini prej Gjakovës
86. Selim Hoxha prej Gjakovës
87. Cajë Daut Aga prej Gjakovës
88. Sulejman Domi prej Gjakovës
89. Muhamet Oruqi prej Gjakovës
90. Shyqeri Hafizi prej Gjakovës
91. Jani Gjini prej Gjakovës
92. Nesho Popoviç prej Gjakovës
93. Boro Jovanoviç prej Gjakovës
94. Qazim Dobruna prej Gjakovës

Prej shokut Ismet Shaqiri nr. 79 deri 93 kanë qenë funksionarë të Partisë dhe të Këshillit Nacionalçlirimtar që kanë ndihmuar për përgatitjen e Luftës.

SHENIMET I DHANË KËTA SHOKË:

1. Sani Hoxha
2. Mazllum Baraku
3. Xheladin Efendija
4. Musa Efendija
5. Mazllum Polcshka
6. Metush Grezda

Xheladin Nixha, Mazllum Baraku, Metush Grezda

LE BATAILLON PARTISAN »BAJRAM CURRI«

R é s u m é

Au cours des mois de mars et d'avril 1943 a été créée la compagnie partisane »Bajram Curri« dans le Malësi de Gjakova, constituée de 95 combattants.

Jusqu'aux combats pour la libération de Gjakova, le 9 septembre 1943, cette compagnie organisa des mouvements d'agitation et de propagande contre les occupants allemands et italiens. La compagnie participa activement à la libération de la ville, en y apportant une contribution évidente.

Par la suite la compagnie augmenta et fut transformée en bataillon, ce qui donna une impulsion à la guerre de libération nationale en Kossova.